



KOLEGJI - COLLEGE  
**BIZNESI**  
Prishtinë

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

### MIDIS

### ASOCIACIONIT TË BIBLIOTEKAVE ELEKTRONIKE TË KOSOVËS

### DHE

### KOLEGJI BIZNESI

Kjo marrëveshje është arritur në Prishtinë më 09.05.2019, ndërmjet:

**Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës** (tash e tutje ABEK), në njërën anë dhe **Kolegjit Biznesi** në anën tjetër.

Në pajtim me këtë marrëveshje palët nënshkruese u morën vesh, si në vijim:

#### Neni 1

Qëllimi i kësaj marrëveshje është anëtarësimi i Kolegjit Biznesi në Asociacionin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës dhe shfrytëzimi i **burimeve dhe materialeve elektronike** të nevojshme për përdoruesit e Kolegjit Biznesi në Prishtinë dhe degët në Prizren, Gjakovë e Vushtrri.

#### Neni 2

Anëtarësimi i palës në ABEK ofron mundësinë e shfrytëzimit të burimeve elektronike të cilat sigurohen nga ABEK përmes EIFL qoftë falas apo me pagesë, burime elektronike këto për Kosovë.

#### Neni 3

Kolegji Biznesi obligohet që në emër të anëtarësimit vjetor në ABEK të paguajë shumën 200 € (euro) e cila paguhet në llogarinë rrjedhëse të ABEK-ut.

#### Neni 4

ABEK mban kontakte të vazhdueshme me anëtarët për informim rreth aktiviteteve, nevojave, prioriteteve dhe synimeve, si dhe u pergjigjet atyre.

#### Neni 5

Kolegji Biznesi mban kontakt të vazhdueshme për informim me zyrën qendrore të ABEK-ut rreth aktiviteteve, nevojave dhe synimeve të bashkëpunimit reciprok në nivel vendor, rajonal dhe ndërkombëtar.

#### Neni 6

ABEK prezanton dhe përkrahë interesat e anëtarëve të tij në nivel të organizmave vendor dhe në nivele të tjera.

#### Neni 7

ABEK krijon mundësitë për shfrytëzimin e burimeve elektronike të nevojshme për Kolegjin Biznesi, përmes trajnimeve dhe botimeve me interes.

#### Neni 8

Marrëveshja nënshkruhet në 2 (dy) kopje.

#### Neni 9

Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët dhe zgjat për aq sa palët kontraktuese kanë interes dhe përmbushin obligimet që dalin nga marrëdhëniet kontraktuale.

#### Neni 10

Kjo marrëveshje shkëputet me paralajmërim 30 ditë përpara nëse ABEK nuk ofron informacione për të rejtat rreth burimeve elektronike.

**ABEK**

Bukurije Haliti  
Koordinatore



**Kolegji Biznesi**

Prof. dr. Shyqeri Kabashi  
Dekan



Prishtinë  
09.05.2019